

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Isa Kelmendi kryetar, Shukeri Sylejman dhe Emine Kaçiku anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Kryqi i Kuq i Kosovës në Prishtinë, të cilin e përfaqëson B. Sh. avokat nga ..., kundër të paditurës KS "i." në Prishtinë të cilën e përfaqëson D. K. sh.p.k në Prishtinë, për përmbushjen e obligimit ligjor duke vendosur përkitazi me revizionin e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1165/2017 datë 12.06.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 15.04.2019, morri këtë :

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e revizionit e të paditurës, NDRYSHOHEN aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1165/2017 datë 12.06.2018, dhe ai i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.546/2013 datë 16.11.2016, ashtu që refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Kryqi i Kuq i Kosovës në Prishtinë që të detyrohet e paditura KS "i." në Prishtinë në emër të grumbullimit të bruto primit nga sigurimi i automjeteve për 1 % për periudhën prej datës 05.08.2010 e deri më datë 31.07.2016, të paguaj shumën 248.648,16 € dhe kamatën sipas mjeteve të deponuara pa destinim të caktuar në Bankë mbi një vit nga dita e marrjes së aktgjykimit dhe shpenzimet e procedurës në shumë 1.065,00 € të gjitha në afat prej 15 ditësh.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1165/2017 datë 12.06.2018, është refuzuar si e pa themeltë ankesa e të paditurës KS "i." në Prishtinë, ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.546/2013 datë 16.11.2016, me të cilin është aprovuar kërkesëpadia e paditësit Kryqi i Kuq i Kosovës në Prishtinë, dhe është detyruar e paditura KS "i." në Prishtinë që në emër të grumbullimit të bruto primit nga sigurimi i automjeteve për 1 % për periudhën prej 05.08.2010, e deri 31.07.2016 të paguaj shumën 248.648,16 €, kamatën sipas mjeteve të deponuara pa destinim të caktuar në Banka mbi një vit nga dita e marrjes së aktgjykimit dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1.065,00 € e të gjitha në afatin prej 15 ditëve.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së shkallës së dytë e paditura me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të referoj lenden në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës për të shqyrtuar përputhshmërinë e nenit 14 paragrafi 1.7 të Ligjit nr.03/L-179 për Kryqin e Kuqë të Republikës së Kosovës me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si dhe më konventën evropiane për të drejtat e njeriut dhe protokollet e saj e pastaj ti ndryshoj aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët dhe të refuzoj kërkesëpadinë apo ti prish dhe lenden te kthen në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të nenit 215 të ligjit mbi procedurën kontestimore dhe pas marrjes së aktgjykimit KO 157/18 datës 8 mars 2019 nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës gjeti se:

Revizioni është i bazuar.

Paditësi - Kryqi i Kuqë i Kosovës me padi dhe në shqyrtimet e mbajtura para gjykatës së shkallës së parë pretendon se është e vetmja shoqatë humanitare vullnetare dhe jo fitimprurëse në territorin e Republikës së Kosovës. Me ligjin e Kryqit të Kuq të Kosovës me nenin 14 pika 1 paragrafi 1.7 është paraparë se Kryqi i Kuqë i Kosovës pos tjerave siguron mjetet financiare edhe nga sigurimi i obligueshëm i automjeteve 1 % nga bruto primi i vlerës së sigurimit të automjeteve. Me që e paditura nuk është përmbajtur dispozitës së ligjit të lart cituar duke ndarë mjete të caktuar për paditësin i njëjti ka parashtrua padi në gjykatë me të cilin ka kërkuar që e paditura në emër të grumbullimit të bruto primit nga sigurimi i automjeteve për 1 % për periudhën prej datës 05.08.2010 e deri me datën 31.07.2016 të detyrohet ti paguaj shumën prej 248.648,16 € me kamat si dhe shpenzimet procedurale. Lartësia e kërkesëpadsisë është vërtetuar nga mendimi i ekspertit ekonomiko- financiar A. B.

Gjykata e shkallës së parë në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike ka gjetur se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar andaj ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit në tërësi dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e të paditurës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë duke pranuar si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të së njëjtës gjykatë.

Me datë 15 gusht 2018 KS “i.” ka paraqitur revizion pran Gjykatës Supreme ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe njëherit kërkoj nga Gjykata Supreme që lënda të referohet në Gjykatën Kushtetuese për vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 14 paragrafi 1.7 të Ligjit për

Kryqin e Kuqë të Republikës së Kosovës a është në përputhshmëri me Kushtetutën, si dhe kërkoj suspendimin e marrjes së vendimit deri në nxjerrjen e një vendimi nga Gjykata Kushtetuese. Gjykata Supreme e Kosovës si gjykatë referuese me datë 15 tetor 2018 dorëzoi kërkesën në gjykatën Kushtetuese për vlerësimin e përputhshmërisë së dispozitës së nenit 14 paragrafi 1.7 të Ligjit të kontestuar më Kushtetutë.

Gjykata Kushtetuese me aktgjykimin e saj KO 157/18 datës 28 mars 2019 nën pikën I të dispozitivit deklaroi kërkesën e pranueshme. Nën pikën II të dispozitivit shpallë që paragrafi 1.7 i nenit 14 të Ligjit nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës, nuk është në pajtueshmëri me neni 24 (barazia para ligjit), neni 119 (parimet e përgjithshme), dhe nenin 46 (mbrojtja e pronës) të Kushtetutës. Nën pikën III të dispozitivit vendos në pajtim me neni 116 .3 të Kushtetutës që paragrafi 1.7 i nenit 14 të Ligjit nr.03/L-179 për Kryqin e Kuq të republikës së Kosovës është i pa vlefshëm nga dita e hyrjes në fuqi të këtij aktgjykimi.

Duke u gjendur në një gjendje të tillë faktike Gjykata Supreme e Kosovës konkludon se janë të bazuar pretendimet në revizion se me rastin e vendosjes nga gjykatat e instancës më të ulët ka ardhur gjer te aplikimi i gabuar e të drejtës material për çfarë arsye që të dy aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulëte është dashur të ndryshohen dhe kërkesëpadia e paditësi të refuzohet si e pabazuar. Kjo aq më tepër se me dispozitën e nenit 116 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës parashihet se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.

Nga sa u tha më lartë e me zbatim të nenit 224 .1 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.336/2018 datë 15.04.2019

Kryetar i kolegjit

Isa Kelmendi